Përmbledhje e komenteve/rekomandimeve nga takimi me shoqerine civile

Falenderim ne emer te projektit per shoqerine civile dhe grupet e interesit qe morren pjese ne takimin e organizuar nga keshilli i bashkise, me synim rritjen e komunikimit midis tyre dhe angazhimin konkret per te permiresuar vendimarrjen e keshillit ne funksion te kerkesave dhe interesave te qytetareve.

Titulli i Takimit: Roli i shoqërisë civile për një Këshill Bashkiak të suksesshëm
Qellimi: Krijimi i më shumë kanaleve të komunikimit, instrumentave dhe mekanizmave ndërveprues ndërmjet këshillit dhe qytetarëve, ku shoqeria civile eshte hallka me e rendesishme

Takimi u organizua ne daten 2 Tetor 2025, ora 10:00 ne Sallen e Keshillit te Bashkise

Morren pjese 15 persona, 8 femra

Përmbledhje e sesionit:
Takimi u drejtua nga Lindita Oshafi, eksperte e BtF. Mori pjese dhe Valbona Karakaci, drejtuese e projektit te BtF. Per pjesemarresit u be nje prezantim i shkurter per rolin dhe kompetencat ligjore te keshillit te bashkise dhe permiresimet ne kanalet e komunikimit me qytetaret. Vemendja u perqendrua tek mekanizmat dhe format qe duhet te perdore shoqeria civile per zgjidhjen e ceshtjeve me interes publik dhe qe jane kompetence e keshillit, si adresimi i kerkesave e ankesave te grupeve qytetare, peticioneve për ceshtje me interes publik, nisma komunitare për vendimmarrje për grupe interesi/grupe ne nevoje, si mund ti drejtohen Kryetarit të Bashkisë dhe Prefektit për të ushtruar të drejtën e tyre ligjore për rishqyrtim të vendimmarrjeve të KB, gjykatës administrative për shfuqizim të vendimeve të KB kur ato cënojnë të drejtën e qytetarit, si të lobojnë me këshilltarë dhe grupe këshilltarësh për vendimmarrje të drejta në interes të komunitetit.

Pjesemarresit, referuar temes te takimit, bene mjaft propozime per permiresimin e punes dhe te mjeteve te komunikimit me strukturat pergjegjese te keshillit ne interes te qytetareve dhe gatishmerine e tyre per te sjelle nje ndryshim.

Ceshtjet e ngritura nga takimi me shoqerine civile

- Akoma nuk njohim keshilltaret, fushat qe mbulojne per tu adresuar problemet specifike qe kemi nga grupet e interesit qe perfaqesojne.
- Edhe sot ne takim, fakti qe asnje nga keshilltaret nuk eshte ne kete takim, nuk tregon seriozitetin per te bashkepunuar.
- Jane bere zgjedhjet e strukturave komunitare ne lagjet e qytetit dhe kryesite e fshatrave por asnjehere nuk jemi thirrur per te diskutuar per ndonje ceshtje, nuk i njohim, pra jane struktura qe nuk jane sherbim te qytetareve, nuk dime si jane zgjedhur nga ne.
- Ndjekim live ndonjehere mbledhjet e keshillit, por transmetimi eshte shume i dobet dhe nuk degjojme as kryetaren e bashkise dhe as keshilltaret kur diskutojne e marrin vendime per ne.
- Ne sallen e keshillit te bashkise direkt nuk ka vend/hapesire te vecante per ne si shoqeri civile te marrim pjese. Ka patur nje vendim te keshillit te bashkise per te bere rikonstruksion dhe zgerim te salles, por asnje arsye nuk dime pse kjo nuk eshte bere, se eshte ne rradhe te pare vleresim per te zgjedhurit, por edhe per ne si qytetare.
- Lushnja ka shume grupe ne nevoje dhe probleme sociale, persona me aftesi te kufizuar,

pensioniste te vemuar etj. Ne kemi mundur qe nepermjet punes sone te bindim donatoret qe te investojne ne Lushnje per te ngritur nje qender sociale, por ne shume takime me kryetaren e bashkise nuk kemi mundur te sigurojme ndonje truall publik apo ndonje ndertese publike per ndertimin e nje qendre te re, shume te domosdoshme per keto shtresa.
- Nuk kemi marre asnjehere ndonje njoftim individual per ndonje mbledhje te vecante te KB apo te komisioneve per ceshtje qe kerkojne ekspertizen dhe mendimin tone si shoqeri civile.
- Keshilli i bashkise ka marre nje vendim per vitin 2025 sipas propozimeve qe kemi bere ne Bashki, dhe ka miratuar dhe nje fond te vecante per rinine. Ne kemi kerkuar disa here prane bashkise qe te mbeshtese projektet tona sipas marreveshjes se bashkepunimit, dhe fondit te miratuar, por asgje nuk ka ndodhur, fondi ka mbetur ne leter. Ne nuk njohim asnje rast qe Keshilli i Bashkise te kete verifikuar kete vendim qe nuk zbatohet, as ka kerkuar ndonje sqarim nga ne si grup rinor. As ne raportet e keshillit apo te bashkise nuk kemi lexuar ndonje analize te arsyeve pse bashkia apo keshilli nuk zbaton vendimet e marra.
- Ka nje jete te vaket kulturore ne bashki, mungese te transportit qytetas, brenda bashkise, ceshtje mjedisore. Keto ceshtje qe jane objekt i vendimarrjeve te keshillit, kerkojne qe te thirremi kur komisionet i diskutojne apo kur keshilli merr ne analize drejtorite perkatese, qe dhe ne me projektet tone te sensibilizojme per te zgjidhur ceshtjet e infrastruktures kulturore, sidomos per rinine tone.
- Media lokale nuk angazhohet per ceshtje te vecanta te ndjeshme per qytetaret as nga Bashkia dhe as nga KB. Ka nje vendim te keshillit bashkiak per te angazhuar median, por as nuk zbatohet dhe as nuk raportohet arsyeja pse nuk zbatohet. Nuk vleresohet media per ndikimin qe ka per bashkine, qytetaret por edhe per keshillin e bashkise. Edhe permiresim te transmetimit mund ta ofroje media lokale, qe eshte problem per keshillin.
- Nuk kane mundesi qe te gjitha grupet e interesit te perdorin tekonologjine per marrjen e informacionit per mbledhjet e keshillit dhe komisioneve. Duhet te perdoren dhe forma dhe mekanizma te tjera per te komunikuar me keto kategori qe jane te shumta ne bashkine tone.
- Kemi bere ankesa dhe kerkesa prane bashkise por shpesh nuk marrim asnje pergjigje. Kemi kerkuar qe tarifat per OJF median etj, per vete misionin e tyre publik, te jene pak me te ulta, referuar dhe niveleve qe aplikojne dhe bashkite e tjera.

Rekomandime per te zgjidhur disa ceshtje bashke me keshilltaret

- Te krijojme rrjetin e komunikimit shoqeri civile-keshilltar
a) te pergatisim nje liste te plote me shoqerine civile, me emrat e OJF-ve, intelektualeve dhe personave me ekspertize te vecante profesionale, grupeve te interesave te vecante qe kane zgjedhur nje perfaqesues dhe te evidentojme drejtimin e punes e tyre, ekspertizen
b) tu shperndahet te gjithe keshilltareve per ti njohur dhe krijuar lidhjen me ta
c) te organizohet me komisione te vecanta takim i perbashket shoqeri civile-komision specifik qe mbron keto interesa per te permiresuar komunikimin dhe procedurat per te marre vendimet sebashku.
-Te behen te njohur ne faqen e keshillit, por edhe direkt per shoqerine civile emrat e strukturave qytetare qe jane zgjedhur, pra te kryetareve te lagjeve dhe kryesive te fshatrave, per te bashkepunuar me ta dhe per te sjelle sebashku ne keshill problemet dhe shqetesimet qytetare, per te ndihmuar komisionet ne organizimin e takimeve publike, psh per buxhetin etj.
- Me grupin e te rinjeve, me median lokale, me drejtuesin e ceshtjeve sociale te analizohen nga keshilli/komisionet specifike kerkesat konkrete te tyre dhe vendimet e pazbatuara te keshillit per vitin 2025. Keshilli te marre ne analize per muajin tetor drejtori te vecanta pergjegjese qe

lidhen me vendimarrjet e tyre, si vendimi per fondet e grupit rinor, per median lokale, per propozimin e drejtuesit te shtresave me probleme sociale per ngritjen e nje qendre sociale ne Bashki me fonde donatoresh. Megjithese keto ceshtje jane ezauruar me ekzekutivin, te analizohen edhe njehere nga komisionet perkatese qe mbrojne keto ceshtje dhe me pas te lobohet edhe ne strukturat e tjera pergjegjese sipas ligjit.

- Komunikimi shoqeri civile-keshill/komision specifik te jete me i afert se nje njoftim ne faqen zyrtare apo face book, pra te jete dhe ftese pune dhe bashkepunimi per nje qellim te perbashket.
- Per nje permiresim te transmetimit live te mbledhjeve te keshillit dhe te komisioneve, dhe per transmetimin e problematikave apo puneve te mira, te shikohet altrenativa per bashkepunimin dhe marreveshje te keshillit me median lokale.
- Keshilli ne vendimarrjen per buxhetin afatmesem tani ne muajin nentor, te propozoje fondet per zgjerimin dhe rikonstruksionin e salles se keshillit, vende dhe per qytetaret dhe te rishikoje propozimet e OJF, medias lokale per nivelin e tarifave.
- Perpara se te marre vendime per buxhetin e viteve 2026-2028, tani ne tetor, nentor ne takimet publike qe do te beje keshilli dhe cdo komision per ceshtje te vecanta, te perfshije ne keto takime dhe shoqerine civile, grupet e interesit per te rritur interesin qytetar.
- Njoftimet per takime te mos behen vetem ne faqen web te KB, face book, por edhe ne qendrat administrative te ngjiten njoftimet. Me shume zhurme te behet per te ndjekur konsultimet publike. Duhet te dime qe tani kalendarin qe ka Keshilli per takimet publike per buxhetin.
- Disa mbledhje komisionesh per PVendime te canta qe lidhen me nje zone apo grup interesi te vecante te organizohen jo vetem ne sallat e KB, por te xhvendosen dhe tek ne direkt ne baze, qe ti ndjekim dhe te japim mendimet tona.
- Te monitorohet zbatimi i disa vendime te ndjeshme per qytetaret nga KB, duke organizuar median dhe pjesemarrjen e qytetareve ne monitorim
- KB te kete marreveshje pune me mediat lokale per te bere publicitet dhe ngritur ceshtje nga qytetaret per keshilltaret. Edhe ne takimet publike, mire do ishte te kerkonin median prezent per te sensibilizuar qytetaret dhe zgjidhur problemet nga Bashkia

Data e publikimit të përmbledhjes së komenteve/rekomandimeve: 3 Tetor 2025